

Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare, Zhvillimit Strategjik dhe Identifikimit, Drejtoria e Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit Strategjik të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 783 datë 18.12.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 24.07.2024 “Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, urdhrin të Kryeministrit nr. 239, datë 16.12.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike”, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare, Zhvillimit Strategjik dhe Identifikimit, Drejtoria e Koordinimit të Projekteve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit Strategjik të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Drejton të gjithë punën e sektorit dhe përgjigjet për cilësinë e punës së kryer pranë drejtorit të drejtorisë përkatëse;
- Identifikon dhe klasifikon nëpërmjet metodologjisë dhe indikatorëve, infrastrukturën e reja të informacionit në kritike dhe të rëndësishme;
- Koordinon punën me institucionet publike dhe çdo sektor brenda institucionit për draftimin e strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike dhe planit strategjik, që e shoqëron atë, sipas prioriteteve të fushës;
- Mbikëqyr zbatimin e strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike dhe planit të veprimit si dhe harton raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të planit të veprimit nga të gjitha institucionet përgjegjëse;
- Koordinon punën për identifikimin e projekte ndërkombëtare, si dhe kontribuon në hartimin e projekteve për aplikime për projekte ndërkombëtare, në fushën e sigurisë kibernetike, ndjekjen e procedurave të aplikimit, koordinimin dhe zbatimin e tyre;
- Koordinon punën për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me organizata dhe forume ndërkombëtare, partnerë strategjikë dhe institucionet homologe, duke koordinuar procese dialogu dhe vendosur bashkëpunime të reja në fushën e sigurisë kibernetike;
- Ndërmjetëson dhe ndjek realizimin e proceseve të anëtarësimit të Autoritetit në organizma, forume dhe rrjete ndërkombëtare;
- Kontribuon në realizimin e objektivave lidhur me procesin e integritimit evropian sa i përket acquis së fushës së sigurisë kibernetike;

- Mban korrespondencë me infrastrukturat nëpërmjet pikave të kontaktit dhe në çdo kohë ndërvepron për rivlerësimin dhe klasifikimin e infrastrukturave të informacionit;
- Koordinon punën për organizimin e trajnimeve, dhe asiston nëse është e nevojshme, në fushat e veprimtarisë që mbulon institucioni për rritje kapacitetesh;
- Merret në vazhdimësi me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit sipas sektorëve dhe grupeve të interesit, në lidhje me objektivat e strategjisë kombëtare për sigurinë kibernetike, duke pasur në fokus të veçantë aktivitetet në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve në internet.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli minimal i diplomës “Master Shkencor” në Shkenca Juridike/ Shkenca Shoqërore/ Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca Kompjuterike/ Inxhinieri Elektrike/ Informatike Ekonomike dhe Shkenca Ekonomike.

Përvoja: Të ketë minimumi 4 vite përvojë pune në profesion.

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Legjislacionin e Sigurisë Kibernetike;
- Legjislacionin e Nënshkrimit Elektronik;
- Legjislacionin mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara;
- Politikat e jashtme dhe programet e lidhura me këtë fushë;
- Specialitetet brenda fushës së caktuar profesionale;

Aftësi :

- Integruar informacionin me politikat institucionale;
- Identifikuar dhe qartësuar çështje e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale;
- Analizuar, komunikuar, prezantuar, si dhe për të pranuar metoda dhe procedura të reja;
- Aftësi shumë të mira analize, organizimi, komunikimi dhe prezantimi;
- Të njohë mirë gjuhën angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (III-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 29.05.2026, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@aksk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.